



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 25, Nenin 27 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1. dhe 2.2, Nenin 30 dhe Nenin 34 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 4 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L-201);
- Dispozitat e Nenit 2, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 dhe Nenit 34 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Kërkesën për ndryshim/modifikim të licencës për prodhim të energjisë elektrike për TC Kosova "B", e datës 14.07.2014 të ndërmarrjes Korporata Energjetike e Kosovës(KEK SH. A.), adresa: rruga "Nënë Tereza nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; dhe
- Aplikacionin për modifikim të licencës për prodhim të energjisë elektrike për TC Kosova "B", me numër licence ZRRE/Li_05/13_B, në licencë për bashkëprodhim (kogjenerim) të energjisë elektrike dhe termike, e datës 14.07.2014 të ndërmarrjes Korporata Energjetike e Kosovës(KEK SH. A.), adresa: rruga "Nënë Tereza nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

në seancën e mbajtur me datë 23 dhjetor 2014, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **MODIFIKOHET** licenca për prodhim të energjisë elektrike dhënë Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH. A.), Divizioni i Gjenerimit "TC Kosova B", me numër licence ZRRE/Li_05/13_B në **Licencë për bashkëprodhim të energjisë elektrike dhe termike**. Të gjitha dispozitat tjera të Licencës mbesin në fuqi.

A r s y e t i m

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 14.07.2014 ka pranuar nga "KEK" SH.A Kërkesën për ndryshim/modifikim të licencës për prodhim të energjisë elektrike të "KEK" SH.A. për TC Kosova "B" dhe aplikacionin për modifikim të licencës për prodhim të energjisë elektrike për TC Kosova "B", me numër licence ZRRE/Li_05/13_B, në licencë për bashkëprodhim (kogjenerim) të energjisë elektrike dhe termike.
- "KEK" SH.A. , në kërkesën e saj ka theksuar se projekti i kogjenerimit të energjisë elektrike dhe termike ka filluar të implementohet, dhe njëkohësisht janë në fazën e hartimit të marrëveshjes për furnizim me ngordhje e cila do të lidhet në mes të "KEK" SH.A. dhe NQ "Termokos" SH.A. me qëllim të krijimit të kornizës rregullative për të funksionalizuar edhe veprimtarin e ngrohjes pasi që, deri më tani me licencën për prodhimin e energjisë elektrike ky aktivitet nuk ka qenë i lejuar.
- "KEK" SH. A. ka sqaruar se bazuar në dispozitat ligjore ka paraqitur kërkesën për modifikimin e Licencës aktuale për prodhim të energjisë elektrike nga TC Kosova "B", me numër licence



ZRRE/Li_05/13_B në Licencë për Bashkëprodhim të Energjisë Elektrike dhe Termike, në mënyrë që të legalizohet edhe kjo veprimtari e dobishme për shfrytëzim të energjisë elektrike.

- II. ZRRE ka vlerësuar kërkesën për modifikim të licencës si dhe dëshmitë relevante sipas aplikacionit dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Bashkëngjitur Licenca e Modifikuar*


Vendimi i dërgohet:

- Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH. A.)
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar